



VENDIM

Nr. 98, Datë 28.07.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“DENAS POWER” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “DENAS” ME FUQI TË
INSTALUAR 14.5 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 39 pika 3 dhe nenit 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Denas Power” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec ”Denas”;

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (Neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Leje nga institucionet e tjera (neni 9 pika 4.1.5) e cila është në proces, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Denas” me fuqi të instaluar 14.5 MW.
2. Kundërshtimet e palëve të interesuara ndaj këtij aplikimi mund të bëhen brenda 10 ditëve kalendarike nga botimi në gazetë i njoftimit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi fillimin e procedurave të licencimit të këtij subjekti.
3. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit Ahmeti

Në mungesë dhe me porosi

Adriatik BEGO